



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

AKADEMIA E SIGURISË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 11 Prot

Tiranë më, 11/03/2022

V E N D I M

Nr. 06, datë 11.03.2022

P Ë R

PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË "BACHELOR"  
PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

*Bazuar në nenin 48 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; pika 22 e VKM-së nr.881 datë 28.10.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj", i ndryshuar;*

*Në vlerësim të planifikimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;*

Bordi i Administrimit i Akademisë së Sigurisë në mbledhjen e datës 11.03.2022, pasi shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe vlerësoi kapacitetet infrastrukturore të Akademisë së Sigurisë;

V E N D O S I :

1. Të miratojë 100 (njëqind) kuota për pranimet në programin e studimit në ciklin e parë bachelor (Siguria dhe Hetimi), për vitin akademik 2022 – 2023.
2. Sekretaria të protokollojë, administrojë këtë Vendim.
3. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Senatit Akademik dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I AKADEMISË SË SIGURISË

KRYETARI

Alber DERVISI  
  
